



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

KRYETARE

Nr. 357/1 Prot.

Shkodër, më 27/09 / 2023

VENDIM

Nr.11, Datë 26.09.2023

“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIV TË ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e Datës 26.09.2023, me propozim të Kryetares së Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi shqyrtoi materialin e përgatitur nga zyrtarët e administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër “Për miratimin e nivelit të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër”, bazuar në: Ligjin Nr.139/2015, Datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përkatësisht në Nenin 8, pika 2) dhe Nenin 77, gërma ç); Ligjin Nr. 152/2013 ‘Për Nëpunësin Civil’ (i ndryshuar); Ligjin Nr.7961, Datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë ” (i ndryshuar); VKM-në Nr.328 Datë 31.05.2023 ”Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore”, Ligjin nr. 35/2023’Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vëndi”, VKQ nr.3, datë 29.12.2022 “Për miratimin e Strukturës Organizative dhe nivelin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër” shkresës nr. 12674, datë 10.07.2023”Dërgohet akordimi i fondit për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023”, pasi u diskutua në mbledhjen e kryesisë së Këshillit të Qarkut Shkodër dt.20.09.2023, bazuar në rregulloren për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, pas relatimit nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit



dhe pas diskutimit nga anëtarët e keshillit, u kalua në procesin e votimit ku u *miratua* me **13**
Vota Pro, 0 Vota Kundër dhe 0 Vota Abstenim;

VENDOSI:

1. Të miratojë nivelin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër, sipas tabelës bashkangjitur.
2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i VKM nr. 328, datë 31.05.2023, fillojnë nga data 1 Prill 2023 dhe do të përballohen nga;
 - Fondet e miratuara, sipas detajimit të Buxhetit të Vitit 2023;
 - Fondi shtesë në shumën 560,160 lekë që i është akorduar Këshillit të Qarkut Shkodër.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetarja e Këshillit të Qarkut Shkodër.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

KRYETARE

Marina DUHANI





KESHILLI I QARKUT SHKODER
STRUKTURA DHE NIVELI I PAGAVE TË ADMINISTRATËS SË
KESHILLIT TE QARKUT PER VITIN 2023

(Periudha 1 Prill deri 31 Dhjetor 2023)

Nr Ren	Nr Pu nonjës sipas drejt.	Njesia Strukturore	Klasa	Klasa Kategoria	Paga e nivelit e kualifikimit	Shtesa 2% e vjeter. mbi pag e grupit	Paga per pozicion dhe per klasë
1	2	3		4	5	6	7
1	1	Kryetar I Këshillit të Qarkut					170,000
2	1	Zv.Kryetari Këshillit të Qarkut					125,000
3	1	Sekretar i Këshillit të Qarkut		I-b	14,000	2%	112,500
		Drejtorja e Financës dhe Buxhetit					
1	1	Drejtor Drejtorie		II-b	14,000	2%	91,000
2	1	Përgjegjës Sektori I Prokurimeve		III-a1	14,000	2%	80,300
3	1	Specialist Finance & Prokurimesh		III-b	14,000	2%	70,000
4	1	Specialist i Emergjencave & Sekretari Arkives		III-b	14,000	2%	70,000
5	1	Specialist I Programim Zhvillimit & Burimeve Njerzore		III-b	14,000	2%	70,000
		Drejtorja e Zhvillimit & Bashkep. me jashte					
6	1	Drejtor Drejtorie		II-b	14,000	2%	91,000
7	1	Specialist I Planifikimit dhe Zhvillimit Territorial		III-b	14,000	2%	70,000
8	1	Specialist I Çeshtjeve Sociale		III-b	14,000	2%	70,000
9	1	Punonjës I funksioneve mbeshetese e operative	VIII			1%	47,000
10	1	Specialist I Komunikimit e Informacionit	VIII			1%	47,000

Shtesa per vjetersi ne punë e përcakuar në masën 2%, jepet pas çdo viti pune, deri ne 25 vjet dhe llogaritet mbi nivelin e kualifikimit.
Shtesa per vjetersi ne punë e përcakuar në masën 1%, jepet pas çdo viti pune, deri ne 25 vjet dhe llogaritet mbi pagen per klasë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI I QARKUT SHKODËR

RELACION

“PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIV TË ADMINISTRATËS SË KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR”

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015, Datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, përkatësisht në Nenin 77, gërma ç); ku përcaktohet se: Këshilli i Qarkut ushtron këto kompetenca dhe detyra: “miraton strukturën, organikën dhe kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së qarkut, të njëjsteve e të institucioneve buxhetore në varësi të qarkut, si dhe numrin e personelit të tyre, kërkesat për kualifikim, pagat dhe mënyrat e shpërblimit të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi” – Institucioni i Këshillit të Qarkut Shkodër ka miratuar Strukturën Organizative të Administratës së tij për Vitin 2023 me 3 (tre) të zgjedhur dhe 10 (dhjetë) personel administrativ, gjithsej 13 (trembëdhjetë) persona, me VKQ nr.3, datë 29.12.2022 “Për miratimin e Strukturës Organizative dhe nivelin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër”.

Duke u bazuar në VKM-në Nr.328 Datë 31.05.2023 ”Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njëjsteve të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të njëjsteve të vetëqeverisjes vendore”, Ligjin nr. 35/2023 'Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vëndi”, VKQ nr.3, datë 29.12.2022 “Për miratimin e Strukturës Organizative dhe nivelin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativ të Administratës së Këshillit të Qarkut Shkodër” shkresës nr. 12674, datë 10.07.2023”Dërgohet akordimi i fondit për rritjen e pagave në zbatim të Vendimit nr. 328, datë 31.05.2023” dhe në funksionet që kryen administrata e Këshillit të Qarkut Shkodër , vlerësohet që në këtë mbledhje paraqesim për miratim ndryshimin e nivelit të pagave për periudhën 1 prill 2023 deri 31 dhjetor 2023 sipas VKM-së së mësipërme, hyrë në fuqi me datën 1 prill 2023 sipas tabelës së bashkangjitur. Kjo është bazuar në nenin 105, shkronja “c” e ligjit Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”

ku citohet: "Organi kompetent mund t'i japë fuqi prapavepruese aktit kur kjo lejohet nga ligji dhe është në favor të palëve të interesuara dhe nuk dëmton të drejtat e një pale të tretë."

Diferencat e pagave do të perballohen nga fondet e planifikuara në buxhetin e vitit vitit 2023 në zbatim Paga dhe Sigurime Shoqërore si dhe në fondet shtesë të cilët janë akorduar me shkresës nr. 12674, datë 10.07.2023 në shumën 560,160 lekë për efektin e rritjes së pagave për institucionin e Këshillit të Qarkut Shkodër ne kap.1, Program 01110, art.600 dhe 601, paga dhe sigurime shoqerore.

Bashkëngjitur këtij Vendimi dhe Relacioni do te gjeni:

Strukturën e pagave dhe nivelin e pagave për Administratën e Këshillit të Qarkut Shkodër për Vitin 2023 për periudhën nga hyrja ne fuqi e VKM Nr.328 Datë 31.05.2023 (1 Prill deri 31 dhjetor 2023).

Presim miratimin tuaj për këtë Projekt Vendim.

Nëpunësi Zbatues

Gjyljana MIRUKU

